



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Në mbështetje të nenit 2 paragrafi 2, nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve për mbështetje publike jo-financiare të OJQ-ve të cilat operojnë në teritorin e Komunës së Rahovecit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport përmes kësaj shkrese ju bën thirrje publike për aplikim të gjitha OJQ-ve, të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë brenda Komunës së Rahovecit, të aplikojnë për mbështetje jo-financiare të OJQ-ve, me pronat publike komunale siç janë zyre dhe hapësira të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve të tyre.

Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja jo-financiare për të gjitha OJQ-të që kanë fushveprimtari dhe aktivitete në territorin e Komunës së Rahovecit.

Specifikat e thirrjes publike

- **Thirrja publike për aplikim hapet më 29.04.2021 dhe mbyllet më 28.05.2021 ora 16:00.**
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen.
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DKRS.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i subvencionit (OJQ) do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit

- Projekt-propozimi, përfshirë, agjendën, aktivitetet.
- Formulari i aplikacionit.
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar,
- Certifikata me numër të regjistrimit të OJQ-s dhe me numër fiskal,
- Dëshmi që nuk ka obligime ndaj ATK-së,

Mënyra e aplikimit

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen një kopje e të gjitha dokumentacionit original të kërkuara.
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimit në katin e parë në objektin e Komunës.

	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSIEDUKE OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>406</u> Nr. i faq./Br.str./No.pg <u>205</u>		
Data/Datum/Date <u>28/04/2021</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Bjondina Këlekça

Drejtoreshë

